



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 1361 prot.

Tiranë më 10.9.2018

**URDHËR**

Nr. 211 , datë 10.9.2018

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT MODEL TË TRANSPARENCËS  
PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE”**

Në mbështetje të nenit 6, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

**URDHËRON:**

1. Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur.
2. Autoriteti Publik/ Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore zbatojnë programin institucional të transparencës jo më vonë se data 1 janar 2019.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në fletore zyrtare.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**



## Lidhja Nr. 1

# PROGRAMI MODEL I TRANSPARENCËS PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

## I. HYRJE

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime të rëndësishme të vetëqeverisjes vendore. Transparenca është publikimi i informacionit mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, (organet dhe administrata e bashkisë), menaxhimin financiar, trajtimin e kërkesave për informacion, shërbimet publike që ofron bashkia, pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, legjislacionin dhe aktet e brendshme rregullatore në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe lehtësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Transparenca dhe llogaridhënia janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë dhe ndërtimit të besimit me komunitetin. Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” u garantojnë qytetarëve akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare. Nëpërmjet Programit të transparencës, bashkia [emri i bashkisë] vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Programi model është hartuar në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore në përputhje dhe në zbatim të kushtetutës, ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” si dhe të ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 Për Ratifikimin e “Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”.

## II. PARIME TË PËRGJITHSHME

Për garantimin e të drejtës së informimit, bashkia në hartimin e Programit të Transparencës është bazuar në parimin e:

- a) **Vendosjes në dispozicion të çdo qytetari**, të gjithë informacionit të prodhuar nga veprimtaria e bashkisë (nga organet e saj, administrata, njësitë administrative dhe njësitë e varësisë).
- b) **Ligjshmërisë, transparencës dhe të mos diskriminimit.**
- c) **Ofrimit të informacionit pa pagesë.** Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike i jepet çdo qytetari pa pagesë. Çdo qytetar përfiton informacion pa pagesë deri në ...faqe, mbi këtë numër faqesh qytetari paguan një tarifë shërbimi prej....lekësh.
- d) **Aksesit për këdo.** Aksesit për shtresat më të varfra të komunitetit, qytetarët me aftësi të kufizuara, gratë, të rinjtë, biznesin, fermerët, qytetarët e zonave të largëta etj., merr përparësi.
- e) **Thjeshtëzimit të procedurave** administrative për aksesin në informacion.
- f) **Dhënies së informacionit sa më shpejtë që të jetë e mundur.**

g) **Cilësisë së informacionit.** Çdo informacion në dispozicion të qytetarëve do të jetë:

- i plotë;
- i saktë;
- i përditësuar;
- i thjeshtë në konsultim;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- i pajtueshëm me dokumentet origjinale në administrim të bashkisë;
- lehtësisht i përdorshëm.

### III. INFORMACIONI QË BËHET PUBLIK PA KËRKESË

Për t'i bërë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm të 16 kategoritë e informacionit, të parashikuar shprehimisht në nenin 7 të ligjit Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (në vijim ligji), janë përshtatur me kontekstin e vetëqeverisjes vendore; me misionin, detyrat, funksionet dhe kompetencat e bashkisë. Në këtë optikë tabela përmbledhëse e Programit është ndarë në 7 fusha kryesore:

**Fusha e parë:** *Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë*, përfshin kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë të përcaktuar nga neni 7 (pika: a; d; g; ç, dh) i ligjit. Kjo fushë iu ofron qytetarëve informacion për ndarjen administrativo-territoriale, njësitë administrative përkatëse dhe nën-ndarjet e tyre, për misionin dhe funksionet e bashkisë, për organet e zgjedhura, për administratën e bashkisë, për statistikën vendore, për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit si dhe për të drejtën e kërkesës, ankesave dhe vërejtjeve të qytetarëve që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës së bashkisë.

**Fusha e dytë:** *Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare*, përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar nga neni 7 (pika: dh; e; ë) i ligjit. Këto kategori informacioni janë përshtatur me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore". Në këtë fushë përfshihen informacione që kanë të bëjnë me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë, me programin buxhetor afatmesëm vendor, me paketën fiskale (taksa dhe tarifa), me buxhetin vjetor, me zbatimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e buxhetit, me donacionet si dhe shitjen ose dhënien me qira të pronave dhe asetëve.

**Fusha e tretë:** *Për kërkesat për informim*, përfshin vendosjen në dispozicion të qytetarëve të informacionit që ka të bëjë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim. Përmbledhja e katër kategorive të informacionit të përcaktuar në nenin 7 (pika c; ç; i; dhe k) të ligjit, në një fushë të vetme, lehtëson aksesin e qytetarëve për këto kategori informacioni, i orienton dhe udhëzon ato se si mund të bëjnë një kërkesë për informim.

**Fusha e katërt:** *Mbi shërbimet që ofron bashkia*, përfshin informacion mbi shërbimet që ofron bashkia të përcaktuara në nenin 7 (pika: f; j, ë dhe pjesërisht pika a) të ligjit.

Nëpërmjet kësaj fushe vihet në dispozicion të qytetarëve informacioni për shërbime

publike që ofron bashkia, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, strukturat përgjegjëse, procedurën e ankimit në lidhje me kontratat publike, standardet, treguesit, procedurat për të përfutur shërbime si dhe procedurat e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet. **Fusha e pestë:** *Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore*, informacion i përcaktuar në nenin 7, pika b të ligjit. Kjo fushë u ofron qytetarëve informacion për legjislacionin, politikat, vendimet, urdhëresat dhe urdhrat karakter normativ të organeve të bashkisë. Për të lehtësuar qasjen në informacion, fusha e legjislacionit është ndarë sipas funksioneve.

**Fusha e gjashtë:** *Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje*, përfshin informacion në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare.

**Fusha e shtatë:** *Informacion tjetër*, bashkia vë në dispozicion të qytetarëve informacion të ndryshëm të tillë si proceset e integritit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime dhe vlerësime të ndryshme, veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës etj; vet-organizimi komunitar etj.

#### IV. TABELA PËRMBLEDHËSE E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

[Vendos emrin e bashkisë]

Fusha 1 - Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë							
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin	
1.	<p><b>Organizimi administrativo-territorial, misioni dhe funksionet.</b> Bashkia bën publike:</p> <p><b>1. Ndarjen administrativo-territoriale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësitë administrative dhe nën-ndarjet e tyre</li> </ul> <p><b>2. Të drejtat, përgjegjësitë dhe misionin e bashkisë.</b></p> <p><b>3. Funksionet:</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Funksioneve në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike</li> <li>- Funksioneve në fushën e shërbimeve sociale</li> <li>- Funksioneve në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese</li> <li>- Funksioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit</li> <li>- Funksioneve në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit</li> <li>- Funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik vendor</li> <li>- Funksioneve në fushën e sigurisë publike</li> <li>- Funksionet dhe kompetencat e deleguara</li> </ul>	<p>Neni 7 i ligjit Nr. 119/2014</p> <p>Ligji Nr. 115/2014</p> <p>Neni 23-30 i ligjit nr. 139/2015</p>	<p>a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Menjëherë	Sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Kryetari i Bashkisë	
2.	<p><b>Organi përfaqësues i Bashkisë-Këshilli bashkiak</b> (përbërja, strukturat, detyrat dhe kompetencat). Përfshin bërjen publike të:</p> <p><b>1. Këshilli bashkiak (KB):</b></p> <p><b>1.1 Përbërja dhe strukturat</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Anëtarët</li> <li>- Kryetari i këshillit</li> <li>- Sekretari i këshillit</li> <li>- Komisionet</li> </ul>	<p>Neni 7 i ligjit Nr. 119/2014</p> <p>Ligji Nr. 139/2015</p>	<p>a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Menjëherë	<p>Vendimet e KB - brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre.</p> <p>Njoftimi për mbledhjen e</p>	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Thirrja e mbledhjes - Kryetari i KB</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p> <p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Grupet e këshilltarëve</li> <li><b>1.2</b> Detyrat dhe kompetencat</li> <li><b>1.3</b> Rregullorja e KB</li> </ul>			KB -5 ditë para datës së zhvillimit.		
3.	<p><b>Organi përfaqësues i Bashkisë - Këshilli bashkiak</b> (procesi i vendimmarrjes). Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kalendarit të mbledhjeve të KB</li> <li>- Njoftimet për mbledhjen e KB</li> <li>- Rendin e ditës së mbledhjes së KB</li> <li>- Projekt-vendimet në proces shqyrtimi nga KB</li> <li>- Procesverbalet e mbledhjeve të KB</li> <li>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ</li> </ul>					
4.	<p><b>Organi ekzekutiv</b> (Kryetari i Bashkisë). Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Procedurave të zgjedhjes</li> <li>- Detyrat dhe kompetencat</li> <li>- Të dhënat për arsimin, kualifikimet , paga e kryetarit dhe deklarimi i pasurisë</li> <li>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ</li> <li>- Orari i pritjes së qytetarëve</li> <li>- Adresa postare/ elektronike</li> </ul>					
5.	<p><b>Administrata e bashkisë.</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Strukturës organizative dhe numrin e punonjësve</li> <li>- Rregullores së organizimit dhe funksionimit të administratës</li> <li>- Strukturës së pagave</li> <li>- Orarit të punës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë</li> <li>- Detyrave të administratës së njësive administrative</li> <li>- Organizimit dhe funksionimit të njësive në varësi</li> <li>- Njoftimeve mbi vende të lira pune dhe procedurat e rekrutimit</li> <li>- Adresave postare dhe elektronike e zyrave të bashkisë/njësive administrative/ njësive në varësi të bashkisë</li> </ul>	<p>Neni 7 i ligjit Nr. 119/2014</p> <p>Ligji Nr. 139/2015</p> <p>Ligji Nr. 44/2015</p>	<p>a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Sekretari i përgjithshëm i Bashkisë

	- Drejtuesit e zyrave, njësive administrative dhe njësive të varësive					
6	<b>Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit.</b> Përfshin bërjen publike të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kartës së Auditimit të Brendshëm</li> <li>- Kodit të Etikës për audituesit e brendshëm</li> <li>- Planit strategjik dhe vjetor të njësive të auditimit të brendshëm</li> <li>- Çdo raporti të auditimit të brendshëm të ushtruar në bashki</li> <li>- Çdo raporti përfundimtar të kontrollit të jashtëm (KLSH) të ushtruar në bashki</li> <li>- Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm</li> </ul>	Neni 43/3 i ligjit Nr. 139/2015, neni 7/dh ligji Nr. 119/2014 si dhe neni 8/c dhe neni 12/ç dhe d i ligjit 114/2015	a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë
7	<b>Kërkesa, ankesa, sinjalizime dhe vërejtje që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës.</b> Përfshin bërjen publike të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Procedurave për të bërë kërkesë, ankesë, vërejtje dhe sinjalizime organeve të bashkisë</li> <li>- Rregullores së brendshme për procedurën e shqyrtimit, të hetimit administrativ, të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit</li> <li>- Njësive përgjegjëse që regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet</li> <li>- Adresave postare/ elektronike për depozitimin e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtjeve</li> <li>- Afateve dhe mënyrave të kthimit të përgjigjeve në lidhje me kërkesat, ankesat apo vërejtjet</li> </ul>	Neni 7 i ligjit Nr. 119/2014  Neni 19 i ligjit Nr. 139/2015  Neni 10 dhe 13 të ligjit Nr. 60/2016	a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Sekretari i përgjithshëm i Bashkisë
8.	<b>Statistikat vendore.</b> Përfshin bërjen publike të: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kalendarit të publikimit të statistikave vendore</li> <li>- Statistikave vendore me të dhënat kyçe të Bashkisë sipas fushave kryesore dhe të ndara sipas gjinisë</li> <li>- Strukturës përgjegjëse në bashki për mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore</li> </ul>	Neni 64/1 i ligjit Nr. 139/2015	a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë pas miratimit	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë

Fusha 2 - Transparenca dhe Llogaridhënia Ekonomiko-Financiare

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	<b>Kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor</b>	Neni 33 i ligjit 68/2017 dhe neni 18 i ligjit 139/2015	a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Në 10 ditëshin e parë të janarit	Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë
2.	<b>Paketa fiskale (taksa dhe tarifa).</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Bazës së taksave dhe tarifave 2. Nivelit të taksave dhe tarifave 3. Përfshirjeve dhe lehtësimeve të subjekteve të caktuara 4. Afateve të pagesave 5. Gjohave dhe kamatëvonesave të aplikueshme	Neni 5/b dhe 12 të ligjit 68/2017	a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve) c) Botohen (citet botimet)	Brenda 15 ditëve nga miratimi	Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë
3.	<b>Plani Strategjik i Zhvillimit të bashkisë.</b> Përmban: 1. Politikat për zhvillimin e qëndrueshëm në një afat kohor jo më pak se 5 vite 2. Synimet kryesore për çdo fushë përgjegjësi 3. Veprimet që duhen ndërmarrë duke parashikuar edhe kostot përkatëse 4. Burimet e financimit	Neni 32 të ligjit 68/2017	a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja.....(me link)	10 ditë nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë
4.	<b>Programi buxhetor afatmesëm vendor.</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Dokumentit të parë të programit buxhetor 2. Dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm 3. Dokumentit të plotë të programit buxhetor afatmesëm (përfshirë dokumentacionin shoqëruar) dhe informacionit për dy vitet e fundit,	Nenet 36/4, 36/9, 38/2, 39 të ligjit 68/2017	a) Në faqen zyrtare të internetit - menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Dokumenti i parë brenda datës 5 korrik. Dokumenti i rishikuar. Dokumenti i plotë jo më vonë se data 31 dhjetor.	Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë



	vitin buxhetor dhe tre vitet vijuese për çdo program (5 dokumentat përkatës)					
5.	<b>Buxheti.</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Buxhetit vjetor së bashku me dokumentacionin shoqërues të tij (12 dokumentat përkatës) 2. Treguesve financiarë 3. Numrit të punonjësve buxhetorë, për çdo njësi shpenzuese 4. Regjistrin të parashikimeve të prokurimit publik	Neni 41/6, neni 54 i ligjit 68/2017; neni 41 i ligjit 139/2015	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve) c) Në Buletinin e Njoftimeve Publike	15 ditë pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë.  Regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik 10 (dhjetë) ditë pas miratimit të buxhetit.	Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë
6.	<b>Zbatimi i buxhetit.</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Raportit mujor (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) të përmbledhur mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve (8 raporte)	Neni 44/4 i ligjit 68/2017	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)  b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Jo më vonë se data 10 e muajit pasardhës	Kryetari i Bashkisë  Informohet Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë
7.	<b>Monitorimi dhe mbikëqyrje</b> e buxhetit: 1. Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit (jo më pak se tre raporte katër-mujore) 2. Raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit 2.1. Raportit të performancës vjetore 2.2. Pasqyrave financiare vjetore (dokumentacionin bazë dhe shoqërues) 3. Informacionit për zbatimin dhe monitorimin e kontratave (punëve publike, mallrave, shërbimeve) 4. Regjistrin të realizimeve të procedurave të prokurimit publik	Neni 48/3, neni 51 dhe neni 54 i ligjit 68/2017, neni 43 i ligjit 139/2015 dhe ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)  b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Raportet e monitorimit brenda 30 ditëve pas përfundimit të periudhës së raportimit.  Raporti vjetor i konsoliduar brenda muajit qershor të vitit buxhetor pasardhës.  Regjistri i realizimeve të	Raportet e monitorimit të zbatimit. Kryetari i Bashkisë (Informohet Këshilli i Bashkisë)  Raporti vjetor i konsoliduar miratohet nga këshilli bashkiak.  Regjistri i realizimeve të prokurimit.	Kryetari i Bashkisë

				procedurave të prokurimit publik jo më vonë se datat 10 maj, 10 shtator dhe 10 janar të çdo viti.	Kryetari i Bashkisë (Informohet Këshilli i Bashkisë)	
8.	<b>Vështirësitë financiare.</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Planit për daljen nga situata e vështirë financiare	Neni 56/4 i ligjit 68/2017	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve) c) Në Buletinin e Njoftimeve Publike	Brenda 10 ditëve nga shpallja.	Këshilli Bashkiak	Kryetari i Bashkisë
9	<b>Shitja ose dhënia me qira e pronave dhe aseteve</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Aseteve dhe pronave të ofruara për shitje ose dhënie me qira 2. Kriteret që duhet të plotësohen	Neni 19 i ligjit 68/2017	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve) c) Në Buletinin e Njoftimeve Publike		Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë
10	<b>Donacionet.</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Emrit të donatorit 2. Shumës së donacionit 3. Qëllimit të donacionit	Neni 20/5 të ligjit 68/2017	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)  b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Kryetari i Bashkisë

## Fusha 3- Për kërkesat për informim

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	<b>Të dhënat e koordinatorit për të drejtën e informimit (Emri, kontaktet dhe kompetencat)</b> Përfshin bërjen publike të: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Emrit mbiemrit të Koordinatorit</li> <li>2. Adresës postare/elektronike të tij</li> <li>3. Orarit të punës</li> <li>4. Detyrave dhe kompetencave të Koordinatorit</li> <li>5. Adresës postare/elektronike për depozitimin e kërkesave për informim</li> </ol>	Neni 7/ç i ligjit nr. 119/2014 dhe neni 15/3 i ligjit nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohen adresa e vendeve)	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
2.	<b>Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankesës.</b> Përfshin bërjen publike të: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Procedurës që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion</li> <li>2. Adresës postare/elektronike për dërgimin e kërkesës për informim</li> <li>3. Modelit standard të një kërkesë për informim</li> <li>4. Afateve të marrjes së përgjigjes</li> <li>5. Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankesë për mos dhënie informacioni</li> <li>6. Adresës postare/elektronike për dërgimin e ankesës për mos dhënie informacioni</li> </ol>	Neni 7 dhe 11/4 ligjit nr. 119/2014 dhe neni 64/j i ligjit nr. 139/2015	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)	Brenda 48 orëve prej miratimit të tyre	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
3.	<b>Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve.</b> Përfshin bërjen publike të: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të gjitha kërkesave për informim</li> <li>2. Informacionet e dhënë në përgjigje të kërkesave për informim</li> <li>3. Përditësimi i regjistrit</li> </ol>	Neni 7/i i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

4.	<b>Informacion i dhënë më parë</b>	Neni 9 i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)	Menjëherë	Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
5.	<b>Trajtimi i kërkesave për informacion</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Procedurës së regjistrimit të kërkesës në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2. Afateve të trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë 3. Mënyrave të dhënies së informacionit	Neni 11, 12 dhe 14 i ligjit Nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)		Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
6.	<b>Kufizimi i së drejtës së informimit</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Rasteve të kufizimit të së drejtës për informim;	Neni 17 i ligjit Nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)		Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
7.	<b>Tarifa për dhënien e informacionin (nëse ka)</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Tarifave 2. Rregullave për mënyrën e kryerjes së pagesës 3. Subjekteve që përfitojnë informacionin falas	Neni 13/1 i ligjit Nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	Koordinatori për të drejtën e informimit
8.	<b>Informacionet dhe dokumentet që kërkohen shpesh.</b> Përfshin bërjen publike të: 1. Gjithë informacioneve dhe dokumenteve të kërkuara më shpesh nga publiku me kërkesë për informim	Neni 7/k i ligjit nr. 119/2014	a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link) b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë	Koordinatori për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit

Fusha 4 - Mbi shërbimet që ofron bashkia

Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	<p><b>Shërbimet</b> Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron bashkia sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Shërbimet në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike</li> <li>2) Shërbimet në fushën e shërbimeve sociale</li> <li>3) Shërbimet në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese</li> <li>4) Shërbimet në fushën e mbrojtjes së mjedisit</li> <li>5) Shërbimet në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit</li> <li>6) Shërbimet në fushën e zhvillimit ekonomik vendor</li> <li>7) Shërbimet në fushën e sigurisë publike</li> <li>8) Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.....</li> </ol> <p>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshtatues mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Instrumentin për administrimin e shërbimit</li> <li>✓ Sistemin e administrimit të performancës së shërbimit bazuar mbi standardet</li> <li>✓ Sistemin e treguesve, përfshirë edhe aspektin gjinor për matjen e performancës</li> <li>✓ Strukturën përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës së shërbimit, përfshirë edhe aspektin gjinor</li> </ul>	Neni 32-33 i ligjit nr. 139/2015	<p>a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit
2.	<p><b>Shërbimet administrative</b> Përfshin bërjen publike të shërbimeve publike që ofron bashkia sipas fushave të përcaktuara nga ligji 139/2015</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) Shërbimet administrative në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike</li> </ol>		<p>a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktuara</p>	Menjëherë	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për të drejtën e informimit

	<p>2) Shërbimet administrative në fushën e shërbimeve sociale</p> <p>3) Shërbimet administrative në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese</p> <p>4) Shërbimet administrative në fushën e mbrojtjes së mjedisit</p> <p>5) Shërbimet administrative në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit</p> <p>6) Shërbimet administrative t në fushën e zhvillimit ekonomik vendor</p> <p>7) Shërbimet administrative në fushën e sigurisë publike</p> <p>Shërbimet administrative në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara</p> <p>Për çdo shërbim (por pa u kufizuar) informacion përshkrues mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Strukturat përgjegjëse për ofrimin e shërbimit</li> <li>- Adresën postare/elektronike të strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative</li> <li>- Procedurat që duhen ndjekur për të përfutur shërbime administrative</li> <li>- Oraret e punës së strukturave/njësive/sportelevë që ofrojnë shërbime administrative</li> <li>- Tarifat për shërbimet administrative</li> <li>- Rregullat për mënyrën e kryerjes së pagesës</li> <li>- Subjektet që përjashtohen nga tarifat</li> </ul>		<p>për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)</p>			
3	<p><b>Kontratat publike.</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objektivit të kontratës publike</li> <li>- Numrit të referencës së procedurës/kontratës</li> <li>- Llojit të procedurës</li> <li>- Termave dhe kushteve të kontratës</li> <li>- Kohëzgjatjes së kontratës</li> <li>- Vlerës së kontratës</li> <li>- Dhënave të autoritetit kontraktor</li> <li>- Dhënave të kontraktorit/nënkontraktorit</li> </ul>	<p>Neni 7/ i ligjit Nr. 119/2014 si dhe neni 25 dhe 71 i VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 Për miratimin e rregullave të prokurimit publik</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citohet adresa e vendeve)</p>	<p>Publikimi brenda 5 (pesë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Treguesve për matjen e përbushjes së kontratës</li> <li>- Strukturave publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës</li> <li>- Procedurave që duhet ndjekur për të bërë një ankimim</li> <li>- Raporteve të kontrollit, monitorimit dhe auditimit mbi zbatimin e kontratës</li> </ul>					
4	<p><b>E drejta e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet</b></p> <p>Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Procedurave për të bërë ankesa apo vërejtje në lidhje me shërbimet</li> <li>2. Adresës postare/elektronike për depozitimin e ankesave apo vërejtjeve</li> </ol>		<p>a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	<p>Brenda 10 ditëve nga shpallja e miratimit</p>	<p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Koordinatori për të drejtën e informimit</p>
<b>Fusha 5 - Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore</b>						
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	<p><b>Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore:</b></p> <p>1) I organizuar (jo i detyrueshëm) sipas fushave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Fusha e organizimit dhe funksionimit të bashkisë</li> <li>- Fusha e veprimtarisë ekonomiko-financiare</li> <li>- Fusha e qeverisjes së mirë vendore (integriteti, etika, anti-korrupsioni, transparenca, llogaridhënia etj)</li> <li>- Fusha e infrastrukturës dhe shërbimeve publike</li> <li>- Fusha e shërbimeve sociale</li> <li>- Fusha e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese</li> <li>- Fusha e mbrojtjes së mjedisit</li> <li>- Fusha e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit</li> <li>- Fusha e zhvillimit ekonomik vendor</li> </ul>	<p>Neni 7/b i ligjit nr. 119/2014</p>	<p>a)Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	<p>Menjëherë pas botimit në fletore zyrtare.</p> <p>Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit dhe kryetarit bashkisë brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre</p>	<p>Kuvendi i Shqipërisë</p> <p>Këshilli i Ministrave</p> <p>Ministri</p> <p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Koordinatori për të drejtën e informimit</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Fusha e sigurisë publike</li> <li>- Fusha e funksioneve dhe kompetencave të deleguara</li> <li>2) Çdo fushë duhet të përmbajë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse</li> <li>- Dokumentet politike kombëtar përkatës</li> <li>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e këshillit të bashkisë me karakter normativ</li> <li>- Vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e kryetarit të bashkisë me karakter normativ</li> <li>- Dokumentet politike vendor</li> </ul> </li> </ul>					
<b>Fusha 6 - Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje</b>						
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	<b>Të dhënat e koordinorit për njoftimin dhe konsultimin publik.</b> Përfshin bërjen publike të: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Emër mbiemër të koordinorit</li> <li>2. Adresën postare/elektronike të tij</li> <li>3. Orarin e punës</li> </ol>	Neni 16/2 ligjit Nr. 139/2015 dhe neni 10 ligji Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)  b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Menjëherë pas miratimit të urdhrat të caktimit të Koordinatorit	Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
2.	<b>Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje.</b> Përfshin bërjen publike të: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Akteve që do të konsultohen</li> <li>2. Mënyrat e konsultimit</li> <li>3. Afatet</li> <li>4. Strukturat përgjegjëse</li> </ol>	Neni 6/b i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)  b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak  Kryetari i Bashkisë	Sekretari i Këshillit Bashkiak  Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
3.	<b>Dispozitat e brendshme rregullatorë për këshillimin me publikun.</b> Përfshin bërjen publike të:	Neni 18/2 i ligjit 139/2015 dhe	a) Në faqen zyrtare të internetit-	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak



	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Procedurave, afateve dhe mënyrat e organizimit për çdo formë/lloj konsultimi</li> <li>2. Strukturat përgjegjëse për aktet e detyrueshme për konsultim</li> </ol>	neni 6 ligji 146/2014	<p>menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>		Kryetari i Bashkisë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
4.	<p><b>Akte për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik.</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Listës së akteve për të cilët është e detyrueshme zhvillimi i konsultimit publik</li> </ol>	<p>Neni 18/1 ligjit Nr. 139/2015</p> <p>Neni 5/ç dhe 13/3 e ligji Nr. 68/2017</p> <p>Neni 1/1 dhe 4/c e ligjit 146/2014</p>	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Menjëherë	Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p> <p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
5.	<p><b>Njoftimi për nismën vendimmarrëse me pjesëmarrje</b></p> <p>Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Projektaktit, relacionin shpjegues dhe dokumentave shoqërues të tij.</li> <li>2. Arsyeve të nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë</li> <li>3. Afatit, vendit dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;</li> <li>4. Adresën e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të bashkisë ose të strukturës përgjegjëse për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;</li> <li>5. Vendin dhe datën e organizimit të takimit publik në rastet kur bashkia vendos për organizimin e tij</li> </ol>	Neni 11, neni 13 dhe neni 14 i ligjit Nr. 146/2014	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Menjëherë	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p> <p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
6.	<p><b>Procedura e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve.</b> Përfshin bërjen publike të:</p>	Neni 15 i ligjit Nr. 146/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak

	<ol style="list-style-type: none"> <li>Adresën postare/ elektronike për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve</li> <li>Afatin për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve</li> <li>Mënyrën e mbajtjes së procesverbalit dhe regjistrimit të takimit publik për takimet publike</li> <li>Mënyrën e trajtimit të komenteve dhe rekomandimeve</li> <li>Mënyrën e dhënies së arsyeve për mospranimin komenteve dhe rekomandimeve</li> </ol>		b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)			Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
7.	<p><b>Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim në lidhje me konsultimin publik.</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Subjektet ku mund të bëhet ankesa (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Këshilli i bashkisë, Kryetari i bashkisë);</li> <li>Adresën postare/ elektronike për dërgimin e ankesës</li> <li>Procedurat për të bërë një ankesë në lidhje me këshillimin me publikun</li> <li>Struktura përgjegjëse në nivel bashkie që regjistron dhe shqyrton ankesën</li> </ol>	Neni 21 i ligjit Nr. 146/2014	<ol style="list-style-type: none"> <li>Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</li> <li>Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</li> </ol>	Menjëherë	Këshilli Bashkiak	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p> <p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
8.	<p><b>Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes.</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Numrit të akteve të miratuara nga organet e bashkisë me konsultim publik gjatë një viti.</li> <li>Numrin e përgjithshëm të komenteve dhe rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;</li> <li>Numrin e rekomandimeve dhe komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes</li> <li>Numrin e takimeve publike të organizuara</li> </ol>	Neni 20/1 i ligjit Nr. 146/2014	<ol style="list-style-type: none"> <li>Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</li> <li>Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</li> </ol>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	<p>Sekretari i Këshillit Bashkiak</p> <p>Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik</p>
9.	<p><b>Iniciativa qytetare.</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Mënyrës dhe formës së paraqitjes së iniciativës qytetare</li> </ol>	Neni 20/1 Ligji Nr. 139/2015	a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit	Këshilli Bashkiak	Sekretari i Këshillit Bashkiak

	<p>2. Procedurave të shqyrtimit dhe e miratimit të iniciativës qytetare</p> <p>3. Adresës postare/ elektronike për depozitimin e iniciativës qytetare.</p> <p>4. Mënyrat dhe afatet e kthimit të përgjigjeve për mos miratimin e iniciativës qytetare</p>		b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)			Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik
Fusha 7 - Informacion tjetër						
Nr.	Informacioni që bëhet publik pa kërkesë	Referenca ligjore	Mënyra e bërjes publike së këtij informacioni	Afati kohor për publikim	Organi miratues	Organi përgjegjës për publikimin
1.	<p><b>Bashkia në proceset e integritimit evropian.</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <p>1. Të dhënave për projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritimit në BE</p>	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	Koordinatori për të drejtën e informimit
2.	<p><b>Bashkia dhe shoqëria civile.</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <p>1. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit</p> <p>2. Të dhëna për OJF, përfaqësuesit e medias, biznesit</p> <p>3. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme</p> <p>4. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile</p>	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	Koordinatori për të drejtën e informimit
3.	<p><b>Raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të transparencës.</b> Përfshin bërjen publike të:</p> <p>1. Raporte, studime dhe vlerësime mbi PT</p> <p>2. Sisteme/metodologji matje të PT</p>	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	<p>a) Në faqen zyrtare të internetit- menuja.....(me link)</p> <p>b) Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	Brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre	<p>Këshilli Bashkiak</p> <p>Kryetari i Bashkisë</p>	Koordinatori për të drejtën e informimit
4.	<p><b>Strukturat komunitare</b> Përfshin bërjen publike të:</p>	Neni 7/1 i ligjit nr. 119/2014	a) Në faqen zyrtare të internetit-	Brenda 10 ditëve nga data	Këshilli Bashkiak	Koordinatori për të drejtën e informimit

	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dhënave për strukturat komunitare në fshat</li> <li>2. Dhënave për strukturat komunitare në qytet</li> <li>3. Detyrat, kompetencat dhe kompetencat e strukturave komunitare</li> <li>4. Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këshillave komunitare</li> </ol>		<p>menuja.....(me link)</p> <p>b)Vendet e caktuara për njoftimet publike (citet adresat e vendeve)</p>	<p>c miratimit të tyre</p>		
--	---	--	--	----------------------------	--	--

## V. PROCESI I PËRGATITJES DHE ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

### 1. Përgatitja

Procesi i përgatitjes së projekt-programit të transparencës drejtohet nga Kryetari i Bashkisë duke u mbështetur në Programin model të Transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore, miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me urdhër nr. ... datë .../.../2018.

### 2. Miratimi

Bazuar në nenin 9, 15 dhe 18/3 të ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 4 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe në programin model të miratuar nga Komisioneri, Këshilli Bashkiak me vendim nr..., datë .../... 2018 miraton Programin e Transparencës së bashkisë.

### 3. Publikimi

Brenda 10 ditëve nga data e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak, Programi i Transparencës publikohet (i) në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” (*linku*) (ii) në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.

### 4. Zbatimi

Kryetari i Bashkisë është përgjegjës për zbatimin e përditshëm të Programit të Transparencës. Në ushtrim të kësaj përgjegjësie, Kryetari i Bashkisë me urdhër nr..., datë.../.../201... ka caktuar [emër mbiemër], Koordinator për të drejtën e informimit si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Me urdhër nr..., datë.../.../201... ka caktuar [emër mbiemër], Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Me urdhër nr..., datë.../.../201... ka miratuar Rregulloren e Administratës së bashkisë [*linku*] e cila në nenin ... ka përcaktuar procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të faqes zyrtare të internetit të bashkisë për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës. Në nenin ... janë përcaktuar procedurat, detyrat dhe përgjegjësitë e çdo strukture të administratës për publikimin dhe përditësimin e Programit të Transparencës dhe në nenin ... janë përcaktuar procedurat e trajtimit të kërkesave për informim.

### 5. Monitorimi

Monitorimi kryhet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili mbikëqyr respektimin e dispozitave të ligjit për të drejtën e informimit dhe në rastet kur vërehet mosrespektim i tyre, bën vlerësimin e kundërvajtjes dhe vendos sanksionet administrative përkatëse. Këshilli Bashkiak mbikëqyr informimin e publikut nga ana e bashkisë duke analizuar dhe vlerësuar shkallën e zbatimit të rregullave që ai vetë ka vendosur.

Kryetari i Bashkisë vlerëson dhe mbikëqyr të gjithë procesin e zbatimit të programit të transparencës nga ana e administratës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë. Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës do të bëhet jo më pak se njëherë në vit nga ana e këshillit dhe Kryetarit të Bashkisë.

Aktorët jo-publik që gjithashtu monitorojnë zbatimin e Programit të Transparencës përfshijnë organizatat e shoqërisë civile, median, biznesin, qytetarët dhe grupe të ndryshme. Monitorimi nga aktorët jo-publik luan një rol thelbësor në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe krijimit të besimit qytetar. Çdo raport, studim, monitorim apo vlerësim mbi zbatimin e Programit të Transparencës nga ana e aktorëve jo-publik sapo i vihet në dispozicion bashkisë publikohet në rubrikën përkatëse në programin e transparencës.

#### 6. Rishikimi dhe përditësimi

Në bazë të pikës.....të vendimit të Këshillit Bashkiak Nr....., datë...../...../201... “Për miratimin e Programit të Transparencës” rishikimi i plotë i programit do të bëhet njëherë në 4 vjet (rekomandohet). Rishikimi i Programit të Transparencës bëhet sipas të njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij. Programi i nënshtrohet përditësimit rregullisht.